

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 24
20.11.2014

NR. VENDIMI 21
24.11.2014

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, e përbërë prej:

Ardit MUSTAJ - GJYQTAR

Asistuar prej sekretares Olta Sinanaj, sot me dt.25.11.2014, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike kërkesën e paraqitur prej:

KËRKUES: **Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë**, përfaqësuar nga prokurori Ened Nakuçi.

OBJEKTI:

I) Sekuestrimin e pasurive të paluajtshme:

- 1) Pasuria me nr.xxx, e ndodhur në ZK.xxx, volumi xx, faqe xxx, lloji i pasurisë arë, me sipërfaqe xxx m², regjistruar në emër të A.S. në datën dhe pajisur me çertifikatë pronësië në datën xxx.
- 2) Pasuria me nr.xxx, e ndodhur në ZK.xxx, volumi x, faqe xxx, lloji i pasurisë arë, me sipërfaqe xxx m², regjistruar në emër të A.S. në datën xxx dhe pajisur me çertifikatë pronësië në datën xxx.
- 3) Pasuria me nr.xxx, e ndodhur në ZK.xxx, volumi x faqe xxx, lloji i pasurisë arë, me sipërfaqe xxx m², regjistruar në emër të A.S. në datën xxx dhe pajisur me çertifikatë pronësië në datën xxx.
- 4) Pasuria me nr.xxx, e ndodhur në xxx, volumi x, faqe xxx, lloji i pasurisë arë, me sipërfaqe

xxx m2, regjistruar në emër të A.S. në datën xxx dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën xxx.

5) Pasuria me nr.xxx, e ndodhur në ZK.xxx, volumi x, faqe xxx, lloji i pasurisë arë, me sipërfaqe xxx m2, regjistruar në emër të A.S. në datën xxx dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën xxx.

6) Pasuria me nr.xxx, e ndodhur në ZK.xxx, volumi x, faqe xxx, lloji i pasurisë arë, me sipërfaqe xxx m2, regjistruar në emër të A.S. në datën xxx dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën xxx.

7) Pasuria me nr.xxx, e ndodhur në xxx, volumi x, faqe xxx, lloji i pasurisë arë, me sipërfaqe xxx m2, regjistruar në emër të A.S. në datën xxx dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën xxx.

II) Sekuestrimin e pasurive të luajtshme:

1) Automjeti me targë xxx P, tipi xxx (i blinduar), vit prodhimi xxx, në pronësi të shtetasit A.S.

2) Automjeti me targë xxx S, xxx, tipi xxx, model xxx, vit prodhimi xxx, në pronësi të shtetasit A.S.

3) Automjeti me targë xxx, xxx, tipi xxx, vit prodhimi xxx, në pronësi të shtetasit A.S.

4) Automjeti me targë xxx (furgon), xxx, tipi xxx, model xxx, vit prodhimi xxx, në pronësi të shtetasit A.S.

III) Për Administrimin dhe përdorimin e pasurive të luajtshme dhe paluajtshme të ngarkohet E.O., administratore e Agjensisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

IV) Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbarimit xxx.

BAZA LIGJORE: Nenet 3-7, 11, 12, 14, 15 e vijues të ligjit nr.10192, dt.3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e

krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Gjykata, pasi shqyrtoi aktet dhe dëgjoji prokurorin që kërkoi pranimin e kërkesës për pasuritë e paluajtshme me nr.rendor më lart 1 (një) dhe 2 (dy) si dhe për pasuritë e luajtshme, kurse për pasuritë e paluajtshme me nr.rendor 3 (tre) deri në 7 (shtatë) hoqi dorë nga gjykimi i kërkesës;

VËREN SE:

Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë ka filluar procedimin pasuror nr.x, dt.xxx, sipas ligjit nr.10192, dt.3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Ky procedim ka filluar mbi bazën e referimit të bërë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr.xxx prot., dt.xxx, e cila po hetonte procedimin penal nr.xxx të vitit xxx për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, të parashikuar nga neni 287 i K.Penal, në ngarkim të shtetasve A.S., A.Ç., E.Ç. dhe A.M.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, këtë procedim e kishte regjistruar mbi bazën e materialit të referuar nga policia gjyqësore e Sektorit kundër Krimit Financiar në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë me dt.xxx. Kështu, me dt.xxx, janë regjistruar si persona që i atribuohet vepra penale e “Pastrimit të produkteve të veprës penale” të parashikuar nga neni 287 i K.Penal, për procedimin penal nr.xxx të vitit xxx, shtetasit:

-A.S., (aktualisht i vdekur), i biri i N. dhe Sh., i datëlindjes xxx, lindur në xxx dhe banues në xxx, rruga “xxx”, pall. xxx, shk.x, ap.xx;

-A.Ç., i biri i R. dhe i D., i datëlindjes xxx, lindur në xxx xxx dhe banues në xxx xxx;

-E.Ç., i biri i A. dhe i A., i datëlindjes xxx, lindur në xxx xxx dhe banues në xxx xxx;

-A.M., e bija e B. dhe N., e datëlindjes xxx, lindur dhe banuese në xxx, rruga “xxx”, pall.xx, shk.x, ap.xx.

Nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor xxx janë identifikuar një numër i madh pasurish të regjistruara në emër të shtetasve E.D. (i vdekur), F.D. (e vdekur), A.S. (i vdekur), A.Ç. dhe A.M., të cilat janë sekuestruar me anë të sekuestros preventive të vendosur me vendimin nr.xxx, dt.xxx të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx.

Gjatë hetimit të procedimit penal në ngarkim të shtetasve A.S., A.Ç., E.Ç. dhe A.M., pas hetimeve të kryera nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxx, me vendimin e datës xxx, është konstatuar se shtetasit A.M., A.Ç. dhe E.Ç. nuk kanë kryer veprime që të përbënin ndonjë formë të veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale, pasi të gjitha veprimet

i përkasin fitimit të trashëgimisë mbi pasurinë e shtetasve E. e F.D., fakt për të cilin këta shtetas kanë zhvilluar disa procese gjyqësore civile dhe, për këtë arsye, për këta shtetas hetimet janë pushuar sipas nenit 328/1 gërma “b” e K.Pr.Penale.

Ndërsa për shtetasin A.S., vendimi i pushimit është bazuar në faktin se ky shtetas ka vdekur, bazuar në nenin 328/1 gërma “ë” të K.Pr.Penale. Nga aktet e procedimit penal, rezulton se shtetasi A.S. është vrarë në ngjarjen e datës xxx.

Nga kjo prokurori, me vendimin e pushimit të sipërpërmendur, në bazë të nenit 275 të K.Pr.Penale është urdhëruar edhe i konfiskimi i pasurive të sekuestuara si më sipër.

Nga aktet e paraqitura në këtë gjykim nga Prokuroria për Krime të Rënda, nuk rezulton nëse vendimi i mësipërm është ankimuar apo jo në gjykatën e apelit, pra nëse është bërë apo jo i ekzekutueshëm deri në këto momente.

Lidhur me personin e dyshuar A.S. nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor xxx janë identifikuar disa pasuri të regjistruara në emër të tij, siç rezulton nga të dhënat e dërguara nga Zyra e Regjistrimit e Pasurive të Paluajtshme xxx me shkresën e saj nr.xxx prot., dt.xxx (bashkëngjitur së cilës ndodhen kartelat përkatëse të pasurive) dhe nga Drejtoria e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor me shkresën e saj nr.xxx prot., dt.xxx (bashkëngjitur së cilës ndodhet dokumentacioni përkatës i automjeteve).

Me anë të kërkesës objekt gjykimi, Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, në bazë të neneve 3 dhe 11 të ligjit nr.10192, dt.3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, kërkon që të vendoset nga gjykata sekuestrimi i pasurive në emër të shtetasit Admirim Sako, tashmë i vdekur, si subjekt i veprimit të këtij ligji sipas neneve 3/1 gërma “d” dhe 3/3 të tij dhe konkretisht për pasuritë:

I) Pasuri të paluajtshme:

1) Pasuria me nr.xxx, e ndodhur në ZK.xxx, volumi xx, faqe xxx, lloji i pasurisë arë, me sipërfaqe xxx m², regjistruar në emër të A.S. në datën xxx dhe pajisur me çertifikatë pronësi në datën xxx.

2) Pasuria me nr.xxx, e ndodhur në ZK.xxx, volumi x, faqe xxx, lloji i pasurisë arë, me sipërfaqe xxx m², regjistruar në emër të A.S. në datën xxx dhe pajisur me çertifikatë pronësi në datën xxx.

3) Pasuria me nr.xxx, e ndodhur në ZK.xxx, volumi x, faqe xxx, lloji i pasurisë arë, me sipërfaqe xxx m², regjistruar në emër të A.S. në datën xxx dhe pajisur me çertifikatë pronësi në datën xxx.

4) Pasuria me nr.xxx, e ndodhur në ZK.xxx, volumi x, faqe xxx, lloji i pasurisë arë, me sipërfaqe xxx m², regjistruar në emër të A.S. në datën xxx dhe pajisur me çertifikatë pronësi në datën xxx.

5) Pasuria me nr.xxx, e ndodhur në ZK.xxx, volumi x, faqe xxx, lloji i pasurisë arë, me sipërfaqe xxx m², regjistruar në emër të A.S. në datën xxx dhe pajisur me çertifikatë pronësi në datën xxx.

6) Pasuria me nr.xxx, e ndodhur në ZK.xxx, volumi x, faqe xxx, lloji i pasurisë arë, me sipërfaqe xxx m², regjistruar në emër të A.S. në datën xxx dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën xxx.

7) Pasuria me nr.xxx, e ndodhur në ZK.xxx, volumi x, faqe xxx, lloji i pasurisë arë, me sipërfaqe xxx m², regjistruar në emër të A.S. në datën xxx dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën xxx.

II) Pasuri të luajtshme:

1) Automjeti me targë xxx, tipi xxx (i blinduar), vit prodhimi xxx, në pronësi të shtetasit A.S.

2) Automjeti me targë xxx, xxx, tipi xxx, model xxx, vit prodhimi xxx, në pronësi të shtetasit A.S.

3) Automjeti me targë xxx, xxx, tipi xxx, vit prodhimi xxx, në pronësi të shtetasit A.S.

4) Automjeti me targë xxx (furgon), xxx, tipi xxx, model xxx, vit prodhimi xxx, në pronësi të shtetasit A.S.

Paraprakisht duhet sqaruar se prokuroria, në seancë gjyqësore, hoqi dorë nga gjykimi i kërkesës për disa prej pasurive të sipërcituara, për shkak se, sipas të dhënave të marra nga Zyra e Regjistrimit e Pasurive të Paluajtshme xxx me shkresën e sipërcituar nr.xxx prot., dt.xxx, u konstatua prej saj në seancë se aktualisht ato janë të regjistruara në emër të shtetasës A.M. dhe konkretisht bëhet fjalë për pasuritë e paluajtshme të listuar më sipër me numrat rendorë 3 (tre), 4 (katër), 5 (pesë), 6 (gjashtë) dhe 7 (shtatë). Prandaj, për këtë pjesë të kërkesës për sekuestrim, gjykata, bazuar në nenet 201/1 dhe 299/b të K.Pr.Civile, në lidhje me nenin 7/4 të ligjit nr.10192, dt.03.12.2009, do të vendosë pushimin e gjykimit të saj.

Për pasuritë e tjera, sipas prokurorisë ato rezulton se janë fituar nga personi i dyshuar A.S. gjatë përfshirjes së këtij të fundit në veprimtarinë kriminale të pastrimit të parave dhe se nga hetimi pasuror provohet se ky i fundit dhe familjarët e tij nuk kanë të ardhura të cilat mund të justifikojnë një pasuri të tillë dhe se, nga ana tjetër, ekziston rreziku i tjetërsimit të tyre dhe pamundësisë së zbatimit të masave të këtij ligji, pasi ndaj vendimit të konfiskimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor xxx mund të paraqesin ankim të interesuarit duke kërkuar revokimin apo moskonfiskimin e këtyre pasurive.

Bashkëngjitur kërkesës nga prokuroria janë paraqitur edhe aktet dhe

provat që vertetojnë rrethanat e mësipërme (të administruara në pesë volumet e paraqitura në gjykatë).

Gjykata, çmon se kërkesa e prokurorisë për sekuestrimin e pasurisë duhet pranuar pasi plotësohen kriteret e kërkuara nga nenet 3 dhe 11 të ligjit nr.10192, dt.3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Neni 11/1 i ligjit nr.10192, dt.3.12.2009 në të cilin bazohet kërkesa e prokurorit, konkretisht parashikon:

“1. Me kërkesë të motivuar të prokurorit, gjykata vendos sekuestrimin e pasurive të personave, sipas nenit 3 të këtij ligji, kur ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie që tregon se personi mund të jetë i përfshirë në veprimtari kriminale dhe zotëron pasuri apo të ardhura, që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre dhe kur:

a) ekziston një rrezik real për humbje, marrje apo tjetërsim të fondeve, pasurive apo të drejtave të tjera, mbi të cilat parashikohet vënia në zbatim e masës së konfiskimit, sipas dispozitave të këtij ligji; ose

b) ka dyshime të arsyeshme që tregojnë se zotërimi i pasurive dhe ushtrimi i veprimtarive të caktuara ekonomike, tregtare dhe profesionale janë në gjendje rreziku apo ndikimi nga ana e një organizate kriminale ose që mund të lehtësojnë veprimtaritë kriminale.

...”

Siç u përmend edhe më lart në vendim, shtetasi A.S. ka qënë person nën hetim për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale” të parashikuar nga neni 287 i K.Penal dhe për këtë arsye gjykata konstaton se përmbushen kërkesat e neneve 3/1 gërma “d” dhe 11 të ligjit, sipas të cilave për zbatimin e këtij ligji dhe, në rastin konkret, për vendosjen e masës së sekuestros ndaj pasurive të personave, duhet që ndaj këtyre të fundit të ekzistojë “...një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicie, për: ...d) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet ...287 të Kodit Penal”.

Ligji nr.10192, dt.3.12.2009, përveç personave të dyshuar si të përfshirë në veprimtaritë kriminale të përcaktuara në pikën 1 të nenit 3, e shtrin fushën e zbatimit të tij edhe ndaj trashëgimtarëve të personit subjekt i zbatimit të këtij ligji, brenda një afati prej 5 vjetësh nga data e vdekjes së tij (afat i cili nuk është plotësuar nga rastin në gjykim), bazuar në nenin 3/3 të këtij ligji.

Sipas nenit 3/4 të ligjit nr.10192, dt.3.12.2009, ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e personave, të krijuara përpara hyrjes në fuqi të tij, me kusht që pasuritë të jenë vënë gjatë përfshirjes së dyshuar të personit në veprimtarinë kriminale, sipas këtij ligji.

Nga verifikimet që ka kryer prokuroria në lidhje me aktivitetet e mundshme ekonomike apo të ardhurat e ligjshme e të deklaruara nga ana e subjektit A.S., nuk ka rezultuar ndonjë veprimtari ekonomike e deklaruar apo të

ardhura dhe fitime të ligjshme e të deklaruara prej tij përpara datës së regjistrimit të pronësisë mbi pasuritë e sipërpërmendura, në mënyrë që të justifikohet blerja e tyre. Shtetasi A.S., sipas të dhënave të marra nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, rezulton i regjistruar si person fizik nga data xxx, për ushtrimin e aktivitetit bar-kafe, si biznes i vogël.

Nga ana tjetër, gjykata vlerëson se në lidhje me pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të regjistruara në regjistrat publikë, potencialisht ekziston në çdo kohë rreziku i tjetërsimit të tyre dhe i shkaktimit të pamundësisë për të zbatuar masat parandaluese të parashikuara në këtë ligj, pasi kalimi i pronësisë apo tjetërsimi i tyre bëhet nëpërmjet kryerjes së veprimit juridik përkatës dhe regjistrimit të tij në këto regjistra, pa qenë e nevojshme edhe dorëzimi i sendeve. Për pasojë, me ardhjen në dijeni të një hetimi pasuror që po kryhet apo me paraqitjen e ankimit mbi vendimin e pushimit të çështjes të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor xxx (të përmendur më lart), në çdo kohë është i mundur tjetërsimi i këtyre sendeve. Prandaj, ekziston rreziku real i tjetërsimit të këtyre pasurive nga trashëgimtarët e subjektit në fjalë dhe, për rrjedhojë, gjykata vlerëson se përmbushet edhe kërkesa e nenit 11/1 germa “a” e ligjit nr.10192, dt.3.12.2009.

Gjykata sqaron se masa parandaluese e sekuestros sipas ligjit nr.10192, dt.3.12.2009, është masë me karakter të përkohshëm, me afate të përcaktuara në ligj, që lidhet patjetër me ekzistencën e një hetimi pasuror të filluar dhe ka si qëllim ruajtjen e pasurive të të gjitha llojeve nga humbja apo tjetërsimi dhe, në të njëjtën kohë, heqjen e mundësisë së përdorimit të mëtejshëm të tyre në veprimtaritë kriminale. Kjo masë është në funksion të realizimit të qëllimit kryesor të hetimit pasuror që zhvillohet sipas këtij ligji, atij të konfiskimit të pasurisë kur vertetohen kushtet e parashikuara në këtë ligj.

Gjithashtu, gjykata sqaron se megjithëse gjykimi i kërkesës për sekuestrim sipas ligjit nr.10192, dt.3.12.2009 bëhet vetëm me pjesmarrjen e prokurorit (neni 12/1), trashëgimtarët e subjektit të këtij ligji që preken nga masa parandaluese duhet të njoftohen nga gjykata për vendimin e dhënë në mungesë të tyre dhe ato kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e apelit (nenet 14/2 dhe 27/1).

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 3, 5, 7, 11, 12, 14, 15, 26, 27 të ligjit nr.10192, dt.3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe neneve 306 e vijues, 310, 201/1 dhe 299/b të K.Pr.Civile,

V E N D O S I :

1. Sekuestrimin e pasurive si më poshtë:

1.1 Pasuri të paluajtshme:

a-pasuria me nr.xxx, e ndodhur ne xxx (xxx, xxx), volumi xx, faqe xxx, lloji i pasurisë arë, me sipërfaqe xxx m², regjistruar në emër të shtetasit A.S. në datën xxx dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën xxx;

b-pasuria me nr.xxx, e ndodhur në xxx (Katund i ri, Tiranë), volumi 3x, faqe xxx, lloji i pasurisë arë, me sipërfaqe xxx m², regjistruar në emër të shtetasit A.S. në datën xxx dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën xxx.

1.2. Pasuri të luajtshme:

a-automjeti me targë xxx, tipi xxx (i blinduar), vit prodhimi xxx, në pronësi të shtetasit A.S.;

b-automjeti me targë xxx, xxx, tipi xxx, model xxx, vit prodhimi xxx, në pronësi të shtetasit A.S.;

c-automjeti me targë xxx, xxx, tipi xxx, vit prodhimi xxx, në pronësi të shtetasit A.S.;

ç-automjeti me targë xxx (furgon), xxx, tipi xxx, model xxx, vit prodhimi xxx, në pronësi të shtetasit A.S.

2. Pushimin e gjykimit të kërkesës për pasuritë e mëposhtme:

a-pasuria me nr.xxx, e ndodhur në xxx (xxx, xxx), volumi x, faqe xxx, lloji i pasurisë arë, me sipërfaqe xxx m², regjistruar në emër të shtetasit A.S. në datën xxx dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën xxx;

b-pasuria me nr.xxx, e ndodhur në xxx (xxx, xxx), volumi x, faqe xxx, lloji i pasurisë arë, me sipërfaqe xxx m², regjistruar në emër të shtetasit A.S. në datën xxx dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën xxx;

c-pasuria me nr.xxx, e ndodhur në xxx (xxx, xxx), volumi x, faqe xxx, lloji i pasurisë arë, me sipërfaqe xxx m², regjistruar në emër të shtetasit A.S. në datën xxx dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën xxx;

ç-pasuria me nr.xxx, e ndodhur në xxx (xxx, xxx), volumi x, faqe xxx, lloji i pasurisë arë, me sipërfaqe xxx m², regjistruar në emër të shtetasit A.S. në datën xxx dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën xxx;

d-pasuria me nr.xxx, e ndodhur në xxx (xxx, xxx), volumi x, faqe xxx, lloji i pasurisë arë, me sipërfaqe xxx m², regjistruar në emër të shtetasit A.S. në datën xxx dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën xxx.

3. Administrator i pasurisë së sekuestruar caktohet E.O., administratore pranë Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

4. Për ekzekutimin e masës së sekuestros ngarkohet Zyra e Përmbarrimit Gjyqësor xxx.

5. Ky vendim t'u njoftohet nga sekretaria e gjykatës, sipas rregullave

procedurale civile, trashëgimtarëve të shtetasit A.S.

6. Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë brenda 15 ditëve, ky afat për palët në mungesë fillon nga njoftimi i tyre, ndërsa për vendimin e pushimit lejohet ankim i veçantë brenda 5 ditëve nga njoftimi.

Tiranë, më 25.11.2014.

SEKRETARE
OLTA SINANAJ

GJYQTAR
ARDIT MUSTAJ

